



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.890/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, Arta Ukshini, nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi”, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.890/2021, i paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, Arta Ukshini, nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi”, dega në Ferizaj, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajit, nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi”, dega në Ferizaj, në Vendvotimet: nr.2506D/01R, 2517D/01R, 2504D/01R, 2525D/01R, 2501Y/10R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.890/2021, kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, Arta Ukshini, nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi” me nr. Rendor në listë 6, dega në Ferizaj, në të cilën pretendon se në vendvotimet me nr.2506D/01R, 2517D/01R, 2504D/01R, 2525D/01R, 2501Y/10R dyshon se është bërë shkelje sepse i mungojnë votat e familjarëve të saj

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet nr.2506D/01R, 2517D/01R, 2504D/01R, 2525D/01R, 2501Y/10R

Si provë ka bashkangjitur deklaratat e votuesve të cilët kanë votuar për kandidaten në fjalë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mungesë të votave të kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Komunës së Ferizajit. Arta Ukshini nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi”, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për fletëvotimet për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Ferizajit, nga Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi”, dega në Ferizaj, në Vendvotimet: me nr.2506D/01R, 2517D/01R, 2504D/01R, 2525D/01R, 2501Y/10R, dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale, të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 890/2021 më datën 06.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.